



REPUBLICA E KOSOVES  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA • OPSTINA • MUNICIPALITY  
HANI E FEZIT  
Nr.i Prot. 02/225 Data 09. 12. 2024  
Nr.i Faq. 5

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government

Bazuar në të nenit 76 pika 7 e dispozitive kalmitare të Ligjit me nr. 08/L-137 për Pyjet (*i shpallur në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 9 me dt. 3 Prill 2023*), Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, Rregullore (QRK)-nr.14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive palët e poshtë shënuar lidhin këtë:

## MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT

Për transferimin nga komuna në Agjencinë Pyjore të Kosovës të stafit të pylltarisë, rojeve të pyllit, teknikëve të pylltarisë, përgjegjësve të njësive komunale etj., bashkë me mjetet buxhetore përkatëse, automjetet dhe pajiset tjera, si dhe mjetet përkatëse funksionale, që lidhen me përgjegjësitë dhe detyrat e ndryshme pyjore.

Ky Memorandum i Bashkëpunimit lidhet ndërmjet:

**MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
më tej e referuar si, MBPZHR

**MINISTRISË SË ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL**  
më tej e referuar si, MAPL dhe

**KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT**  
më tej e referuar si, Komuna e Hanit të Elezit

## Neni 1

### QËLLIMI

1. Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është përbushja e objektivit të përgjithshëm kthimit të kompetencave në zbatimin të nenit 76 pikës 7 të Ligjit me nr. 08/L-137 për pyjet.

## Neni 2

### OBJEKTI

1. Objekt i këtij memorandumi bashkëpunimi është zbatimi i e normës juridike të nenit 76 pikës 7 të Ligjit me nr. 08/L-137 për Pyjet, për transferimin nga Komunitat në Agjencinë Pyjore të Kosovës të rojeve të pyllit, teknikëve të pylltarisë dhe përgjegjësve të njësive komunale, bashkë me mijet buxhetore përkatëse, automjetet dhe pajisjet tjera, si dhe mijetet përkatëse funksionale, që lidhen me përgjegjësitë dhe detyrat e ndryshme Pyjore.

## Neni 3

### OBLIGIMET E PALËVE

#### 1. Agjencia Pyjore e Kosovës,

- 1.1 Bën Pranimin nga Komunitat të stafit të sektorit të pylltarisë dokumentacionin përkatës (listës së stafit që transferohet me të dhënët përkatëse, dosjeve personale fizike dhe elektronike) të rojeve të pyllit, teknikëve të pylltarisë dhe përgjegjësve të njësive komunale etj, automjetet dhe pajisjet tjera, si dhe mijetet përkatëse funksionale, që lidhen me përgjegjësitë dhe detyrat e ndryshme të sektorit pyjor;

- 1.2 Organizon shërbimin e mbrojtjes dhe ruajtjes së pyjeve në territorin e Komunës;

- 1.3 Kryen të gjitha obligimet dhe shërbimet tjera sipas ligjit.

## **2. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;**

**2.1** Monitoron procesin e zbatimit të memorandumit të Bashkëpunimit për transferim e kompetencave të përcaktuara me nenin 76 pikës 7 të Ligjit me nr. 08/L-137 për Pyjet, nga komuna tek MBPZHR - APK;

**2.2** Merr pjesë në koordinimin e aktiviteteve te cilat do të realizohen në zbatimin e marrëveshjes gjatë procesit transferimit të kompetencave nga komuna në MBPZHR- APK.

## **3. Komuna e Hamit të Elezit**

**3.1** Përgatitë dhe dorëzon dosjet personale të stafit-personelit që transferohet nga Komuna tek APK konform dispozitive nga Regullorja (MBP) Nr.01/2020 për Përbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;

**3.2** Deri me datë **15.12.2023** përgatitë dhe dorëzon listën e zyrtarëve të sektorit pyjor që transferohet në APK me të dhënat përkatëse si: Kodi buxhetor i Komunës, emri mbiemri i zyrtarit që transferohet, nr. i letërnjoftimit, datëlindja, të dhënat për pagën, pozita e punës, kodi, emërtimi i pozitës sipas ligjit të pagës, kodi në SP, klasa, koeficienti, shtesa në pagë- përvoja e punës si dhe shtesa tjera nëse eventualisht ka, si dhe të dhënat bankare (emri i bankës dhe nr. llogarisë).

**3.3** Përgatit dokumentacionin për transferimin e automjeteve dhe pajisjet tjera si dhe mjetet përkatëse funksionale për transfer nga Komuna tek APK;

**3.4** Përgatit dhe dorëzon raportet e regjistimeve të të gjitha terreneve pyjore të Komunës deri më datë 31.12.2023.

Neni 4

## **AMANDAMENTET**

**1.** Ky Memorandum i Bashkëpunimit mund të ndryshohet apo plotësohet sipas një marrëveshjeje me shkrim miëdis palëve. Ndryshimet dhe plotësimet janë pjesë përbërse e këtij Memorandumi te Bashkëpunimit.

## Neni 5

### DOKUMENTET PËRCJELLËSE

1. Pjesë përbërëse te këtij Memorandumi të Bashkëpunimit janë:

- 1.1 Lista e stafit të zyrtarëve të Njësisë Komunale me të dhënët përkatëse, që transferohet në APK;
- 1.2 Regjistri i inventarit dhe të gjitha aseteve të Njësisë Komunale që transferohet në APK.
- 1.3 Pranim dorëzimi i dokumentacioneve përkatëse dhe aseteve bëhet nga anëtarët e komisioneve të përbashkëta të emëruara me vendim nga APK.

## Neni 6

### ZGJDHJA E KONTESTEVE

1. Kontestet eventuale rreth dispozitave të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit do të zgjidhen me marrëveshjen e palëve kontraktuese, e nëse nuk mund të arrihet marrëveshja, kontestin do ta zgjedh Gjykata kompetente.

## Neni 7

### HYRJA NË FUQI

1. Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi pas nënshkrimit nga ana e palëve.

**PALËT NËNSHKRUËSE:**

**Ministria e Bujqësisë Pylitarisë dhe Zhvillimit Rural**

Ministri i MBBPZHR

Faton PEÇI



B. Peçi  
Data: 06.12.2023

**Ministra e Administrimit të Pushtetit Lokal**

Ministri i MAPL

Elbert KRASNIQI

E. Krasniqi  
Data: 07.12.2023



Komuna Hani i Elezit  
Kryetari i Komunës  
Mehmet BALLAZHI  
Data: 09.12.2023